



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

## KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

### V E N D I M K.P.P. 321/2019

Komisioni i Prokurimit Publik, i përbërë nga:

Evis Shurdha	Kryetar
Enkeleda Bega	Nënkryetar
Vilma Zhupaj	Anëtar
Lindita Skeja	Anëtar
Merita Zeqaj	Anëtar

Në mbledhjen e datës 28.05.2019 shqyrtoi ankesat përkatësisht me:

**Objekt:**

“Shfuqizim i vendimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave në lidhje me skualifikimin e ofertës së operatorit ekonomik “V.A.L.E. Recycling” sh.p.k., në procedurën e prokurimit “Procedurë e hapur”, me nr. REF-02543-12-28-2018, me objekt “Shërbim Eliminim mbetjesh të rrezikshme - Marrëveshje Kuadër me 1 operatorë ekonomik - ku të gjitha kushtet janë të përcaktuara - me afat 1 vjeçar (12 muaj)”, me fond limit 8.910.000 lekë (pa TVSH), zhvilluar në datën 08.03.2019, nga autoriteti kontraktor, Spitali Universitar Obstetrik Gjinekologjik “Koço Gliozheni”.

Shfuqizim i vendimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave në lidhje me kualifikimin e ofertave të operatorëve ekonomikë “Pure – Medical” sh.p.k., “Medi – Tel” sh.p.k. dhe “Eco – Riciklim” sh.p.k., pjesëmarrës në procedurën e mësipërme të prokurimit.”

**Ankimues:**

“V.A.L.E. Recycling” sh.p.k.  
Lezhë, Fushë Kuqe, Gurez, afër ish-Kanalit të Acidit

**Autoriteti Kontraktor:**

Spitali Universitar Obstetrik Gjinekologjik “Koço Gliozheni”  
Bulevardi “Bajram Curri”, Tiranë

**Baza Ligjore:**

Ligji nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar, neni 19/1 e vijues, Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, Vendimi i Komisionit të Prokurimit Publik nr. 596/2018, datë 12.09.2018 “Për miratimin e rregullave “Për Organizimin dhe Funksonimin e Komisionit të Prokurimit Publik”.

Komisioni i Prokurimit Publik, pasi dëgjoi relatorin e çështjes, shqyrtoi parashtrimet me shkrim të ankimuesit, dokumentacionin e paraqitur nga autoriteti, pretendimet e ankimuesit, dhe pasi diskutoi çështjen në tërësi,

**Vëren:****I***Vlerësimi paraprak*

I.1. Pas shqyrtimit paraprak të ankesës të mbështetur në dokumentacionin e dërguar nga operatori ekonomik ankimues, Komisioni i Prokurimit Publik konstatoi se ky i fundit ka *prima facie* interes në këtë procedurë prokurimi dhe për këtë arsye legjitimohet për të paraqitur ankesë në lidhje me të, bazuar në pikën 1 të nenit 63 të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar.

I.2. Operatori ekonomik ka paraqitur fillimisht ankesë pranë autoritetit kontraktor, dhe më pas ka paraqitur ankesë, pranë Komisionit të Prokurimit Publik, si organi më i lartë në fushën e prokurimeve, që shqyrton ankesat për procedurat e prokurimit, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në ligjin nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar.

I.3. Ka respektuar afatet ligjore të paraqitjes së ankesës pranë autoritetit kontraktor dhe Komisionit të Prokurimit Publik.

Në këto kushte Komisioni i Prokurimit Publik mori në shqyrtim në themel objektin e ankesës së operatorit ekonomik ankimues.

**II***Rrethanat e çështjes*

II.1. Në datën 31.12.2018, është publikuar nga autoriteti kontraktor, në faqen e internetit të Agjencisë së Prokurimit Publik, procedura e prokurimit “Procedurë e hapur”, me nr. REF-02543-12-28-2018, me objekt “Shërbim Eleminim mbetjesh të rrezikshme - Marrëveshje Kuadër me 1 operatorë ekonomik - ku të gjitha kushtet janë të përcaktuara - me afat 1 vjeçar (12 muaj)”, me

fond limit 8.910.000 lekë (pa TVSH), zhvilluar në datën 08.03.2019, nga autoriteti kontraktor, Spitali Universitar Obstetrik Gjinekologjik “Koço Gliozheni”.

II.2. Në datën 08.03.2019, autoriteti kontraktor ka zhvilluar procedurën e prokurimit.

II.3 Nga verifikimi në sitemin e prokurimit elektronik (SPE) si dhe referuar informacionit të autoritetit kontraktor të dorëzuar pranë Komisionit të Prokurimit Publik, autoriteti kontraktor në datë 21.03.2019 ka kryer vlerësimin e ofertave të operatorëve ekonomikë pjesmarrës në këtë procedurë prokurimi të cilët kanë paraqitur ofertat ekonomike (pa TVSH), përkatësisht:

- |                                 |                              |
|---------------------------------|------------------------------|
| 1. “V.A.L.E. Recycling” sh.p.k. | 5.900.400 lekë, skualifikuar |
| 2. “Pure – Medical” sh.p.k.     | 6.000.000 lekë, kualifikuar  |
| 3. “Medi – Tel” sh.p.k.         | 8.415.000 lekë, kualifikuar  |
| 4. “Eco – Riciklim” sh.p.k.     | 8.910.000 lekë, kualifikuar  |

III.4. Në datën 21.03.2019, operatori ekonomik “V.A.L.E. Recycling” sh.p.k. është njoftuar elektronikisht për vlerësimin e procedurës së prokurimit si dhe skualifikimin e tij në këtë procedurë për arsyen si më poshtë vijon:

*“Mos paraqitja e dokumentit te lejes se bashkise per depozitimn e mbetjeve spitalore te rrezikshme mbase perpunumit.”*

III.4.1. Operatori ekonomik “V.A.L.E. Recycling” sh.p.k. në datën 27.03.2019 ka paraqitur ankesë pranë autoritetit kontraktor duke kundërshtuar skualifikimin e ofertës së tij ekonomike në procedurën e mësipërme të prokurimit. Gjithashtu, operatori ekonomik ankimues ngre pretendime mbi ofertat e operatorëve të tjerë ekonomikë, të kualifikuar në procedurën e mësipërme të prokurimit. Konkretisht operatori ekonomik ankimues, në ankesën e tij pretendon si më poshtë vijon:

*[...]Nuk jemi dakort me rezultatet e vlerësimit si më sipër, dhe paraqesim kundërshtimet tona në vijim:*

*Së pari: Në pikën 2.3 të Shtojcës 9, nga vetë AK është përcaktuar:*

*“2.3. Për kapacitetin teknik:*

*Në mbështetje të Ligjit Nr. 10463 datë 22.09.2011 “Për Menaxhimin e Integruar të Mbetjeve”, dhe Ligjit nr. 156/2013 “Për disa ndryshime në Ligjin nr. 10463, datë 22.09.2011 Për Menaxhimin e Integruar të Mbetjeve”, Vendimin e Këshillit të Ministrave Nr. 798 datë 29.09.2010 “Për Administrimin e Mbetjeve Spitalore, Ligjin Nr. Nr. 10431, datë 9.6.2011 “Për mbrojtjen e mjedisit”, VKM Nr. 99 datë 18.02.2005 “Për Miratimin e Katalogut Shqiptar të Klasifikimit të Mbetjeve” si mëposhtë do të gjeni specifikimet teknike .*

*Specifikime teknike të përgjithshme për trajtimin e mbetjeve të rrezikshme spitalore, anatomike të lëngshme dhe të ngurta:*

*1.Operatori Ekonomik nuk duhet të veprojë asnjëherë pa praninë e përfaqësuesve të Sektorit të Hotelarisë (Inspektori Sanitar). Për kryrjen e shërbimeve operatori ekonomik duhet të paraqesë situacionin përmbledhës, dokumentat dhe faturat shoqëruese për sa është realizuar, në periudha kohore mujore përkatëse si dhe proces-verbalin për shërbimin e kryer të firmosur mes dy palëve (të operatorit ekonomik dhe përfaqësuesit të Sektorit të Hotelarisë).*

2. Mbetjet e rrezikshme spitalore anatomike të lëngshme dhe të ngurta, duhet të trajtohen në impiant, i cili është i licensuar nga Ministria e Mjedisit për kryerjen e këtij shërbimi.
3. Trajtimi duhet të realizohet me grirje dhe sterilizim, dhe mbetjet të bëhen të parrezikshme.
4. Operatori ekonomik duhet të instalojë një frigorifer (banak frigoriferik), tek ambjenti që do të përcaktojë SUOGJ “Koco Gliozheni”, me kapacitet 200- 250 kg, dhe temperaturë ngrirje deri minus -18 gradë celsius, për ruajtjen e mbetjeve të rrezikshme spitalore anatomike të ngurta dhe të lëngshme, deri në momentin e transportimit me mjetet e tij për në impiantin e trajtimit.
5. Operatori ekonomik do të furnizojë cdo herë që evadon mbetje të rrezikshme spitalore Autoritetin Kontraktues me kontenierë kartoni sipas VKM 798 datë 29.09.2010 “Mbi mbetjet spitalore”, pikat 8/4 dhe 8/5 të kreut III, të certifikuar CE, shoqëruar me certifikatën përkatëse. Volumi i kontenitoreve duhet të jetë:  
Përafërsisht 40-60 L  
Përafërsisht 3 L – 6 L (per Bisturitë, shiringa, instrumente të mprehta)
6. Operatori ekonomik do të evadojë mbetjet e rrezikshme spitalore dy herë në javë, përkatësisht ditën e hënë dhe të enjte.
7. Mbetjet e vendosura në kontenierët përkatës do të peshohen në praninë e përfaqësuesve të dy palëve (peshorja do të ofrohet nga operatori fitues dhe duhet të shoqërohet me akt kolaudimi nga autoritetet përkatëse), ku do të shkruhen në faturë sasia e peshuar, pa përfshirë kutinë e ambllazhimit të transportit, në tre kopje dhe do nënshkruhet nga sipërmarrësi dhe përfaqësuesi i Autoritetit Kontraktor. Dy kopje të kësaj fature do mbeten në SUOGJ “Koco Gliozheni”, dhe një kopje e merr përfaqësuesi i firmës. Ky proces, shkruhet dhe në rregjistrin e mbetjeve spitalore të rrezikshme.
8. Në cmimin e deklaruar nga operatori do të përfshihen: kontenitorët, ambllazhet, që do të dorëzohen pranë Autoritetit Kontraktor, gjithashtu në cmim përfshihen edhe grumbullimi, transporti, trajtimi dhe asgjësimi i mbetjeve të rrezikshme spitalore. Këto (kontenitorët, ambllazhet) duhet të përmbushin standartet e përcaktuara në VKM 798 datë 29/09/2010 “Për administrimin e mbetjeve spitalore”.
9. Pas marrjes në dorëzim të mbetjeve, nga ana e Operatorit Ekonomik do të bëhet dezinfektimi i mirë i frigoriferit dhe i ambjentit ku janë magazinuar mbetjet e rrezikshme spitalore. Kjo do të pasqyrohet nga specialisti i hidroklovës në provecverbalin përkatës të tyre.
10. Transporti i mbetjeve nga ambjenti i magazinimit, në SUOGJ “Koco Gliozheni” deri në impiantin e trajtimit do të bëhet me mjet të posaçëm të sipërmarrësit të identifikuar dhe me ambllazhim përkatës, në përputhje me standartet e OBSH, për mbetje të rrezikshme spitalore anatomike të ngurta dhe të lëngshme.
11. Për transportin e mbetjeve të disponojë minimalisht një automjet te posacem\*, te pajisur me sinjalistiken perkatese per transport mbetjesh te rrezikshme spitalore dhe te pajisur me leje per transportin e mbetjeve te rrezikshme spitalore, ne pronesi apo me qira, të vërtetuar me certifikatë pronesie, dhe te shoqeruar me kontrate qiraje kur mjeti eshte i marre me qira. Mjeti i kërkuar si më sipër, duhet të jetë sipas pershkrimit: “plotësisht i mbyllur që ka një kabinë të ndarë, ose një automjet unitar në të cilën kabina e shoferit është e veçuar plotësisht nga ndarja ku vendosen mbetjet nga një paret i mbyllur i fiksuar.”
12. Të gjitha detyrimet ligjore për zbatimin e VKM 798 datë 29/09/2010 “Për administrimin e mbetjeve spitalore” nga momenti që dorëzohen te përfaqësuesi i firmës janë në ngarkim të operatorit ekonomik.

13. Mbetjet e rrezikshme, që dorëzohen nga një person fizik a juridik te një tjetër, shoqërohen me dokument dorëzimi, i cili është i vlefshëm edhe në formë elektronike.

Dokumenti i dorëzimit përmban të paktën informacionin e mëposhtëm:

a) Numrin e dokumentit të dorëzimit;

b) Emrin, adresën, numrin e telefonit dhe hollësi të tjera kontakti të dorëzuesit;

c) Emrin, adresën, numrin e telefonit dhe hollësi të tjera kontakti të transportuesit;

ç) Emrin, adresën, numrin e telefonit dhe hollësi të tjera kontakti të vendit të destinacionit të mbetjes së rrezikshme (të marrësit në dorëzim);

d) Emrin, adresën, numrin e telefonit dhe hollësi të tjera kontakti të krijuesit të mbetjeve;

dh) Përshkrimin e mbetjeve të rrezikshme, përfshirë listën e kodeve të mbetjeve dhe sasitë respektive;

e) Hollësi për përbërësit kimikë apo biologjikë të mbetjeve të rrezikshme dhe përqendrimit e tyre.

14. Marrësi në dorëzim, kur refuzon një transfertë mbetjesh të rrezikshme, i tregon transferuesit arsyet e refuzimit.

15. Çdo person, që angazhohet në dorëzimin e mbetjeve të rrezikshme, ruan dokumentacionin e transferimit për një kohë prej të paktën 3 vjetësh nga data kur fillon dorëzimi dhe ua vë ato në dispozicion Agjencisë Kombëtare të Mjedisit apo Inspektoratit për Mjedisin, pas paraqitjes së kërkesës së tyre me shkrim. Dokumentacioni përmban të paktën kopje të dokumentit të dorëzimit, kopje të dokumentit të konfirmimit dhe informacion për dorëzimet e refuzuara.

16. Operatori Ekonomik duhet të ketë leje nga bashkia për depozitimin e produkteve që dalin nga përpunimi.

17. Gjatë transportimit të mbetjeve spitalore duhet të respektohen rregullat dhe kërkesat të cilat lejojnë transportin e sigurt të mbetjeve anatomike të lëngëta dhe të ngurta, dhe të parandalohen rrjedhjet apo derdhjet e tyre.

18. Liçencë profesionale, e lëshuar nga QKL kategoria III.2.B / për trajtimin e mbetjeve të rrezikshme spitalore.

19. Leje Mjedisore lëshuar nga Ministria e Mjedisit për mbetjet spitalore (shoqeruar me Akt-Miratimi) ku përfshihen kodet III 1 B.

18 01 01: Bisturitë, shiringa, instrumente të mprehta (përveç 18 01 03)

18 01 03: Mbetjet, grumbullimi dhe asgjësimi i të cilave kërkon trajtim të veçantë për të parandaluar infeksionet

18 01 02 : Pjesë të trupit dhe organe, përfshirë qeset dhe konservuesit e gjakut dhe rezervat e gjakut (përveç 18 01 03)

20. Të jenë të pajisur me:

Certifikatë EN ISO 9001:2015 Sistemi i Menaxhimit të Cilesisë,

Certifikatë EN ISO 14001:2015 Për sistemin e Menaxhimit të Mjedisit,

Certifikatë BS OHSAS 18001:2007 Për Sistemin e Menaxhimit të Sigurisë në Punë.

Shënim: KVO rezervon të drejtën e verifikimit të të dhënave të paraqitura nga ofertuesit.”

Sic vihet re, nga specifikimet e mesiperme, vete AK, kërkesat e pikes 2.3 me siper, i ka konceptuar si specifikime teknike te pergjithshme, disa prej te cilave verifikohen ne fazen e konkurimit, ndersa disa te tjera jane specifikime qe lidhen me fazen e zbatimit te kontrates.

Per disa prej ketyre specifikimeve, AK ka kerkuar dhe ka identifikuar dokumenta konkrete specifike qe OE duhet te paraqesin, ndersa per disa te tjera, vetem i ka pershkruar si specifikime qe duhet te verifikohen gjate hartimit te kontrates dhe nuk ka indikua nje dokument konkret qe OE duhet te

paraqesin per qellime kualifikimi. Ne kete kontekst, nga ana jone, pervec Shtojces 6 "DEKLARATE MBI PERMBUSHEN E SPECIFIKIMEVE TEKNIKE", kemi paraqitur edhe nje VETEDEKLARATE me permbajtjen si vijon: "-Plotesojme të gjitha kapacitetet teknike të kerkuara në pikën 2.3 "Kapaciteti Teknik", të Shtojces 9 te Dokumentave të Tenderit, në mbështetje të Ligjit Nr. 10463 datë 22.09.2011 "Për Menaxhimin e Integruar të Mbetjeve", i ndryshuar, VKM Nr. 798 datë 29.09.2010 "Për Administrimin e Mbetjeve Spitalore, Ligjit Nr. Nr. 10431, datë 9.6.2011 "Per mbrojtjen e mjedisit", VKM Nr. 99 datë 18.02.2005 "Per Miratimin e Katalogut Shqiptar te Klasifikimit te Mbetjeve".

-Aty ku eshte kerkuar, kemi paraqitur edhe dokumentacionin perkates."

Pra, eshte e qarte, se ne pergjigje te menyres se si AK i ka ndertuar keto kerkesa ne formen e specifikimeve, ne me pergjegjesi te plote kemi deklaruar permbushjen e tyre dhe aty ku jane kerkuar dokumenta konkrete, te percaktuar qartesisht, i kemi paraqitur keto dokumenta. Sigurisht, qe nga ana jone, eshte lehtesisht e provueshme se e kemi te realizuar edhe zgjidhjen per depozitimin e produktit te pademshem qe del nga perdorimi (pika 16 e listes se sipercituar te kerkesave specifikimeve teknik). Po ju bashkelidhim per qellime provuese Kontraten perkatese me Landfillin e Bushatit. Sidoqofte, vete AK, ka percaktuar ne fund te listes se sipercituar ne pike 2.3 qe "KVO rezervon te drejten e verifikimit te te dhenave te paraqitura nga ofertuesit "Pra, ne zbatim te ketij percaktimi dhe te nenit 53/1 te LPP, KVO e AK, mund te kishte kerkuar sqarime dhe te bente verifikime per deklarimet tona, nisur edhe nga fakti, qe oferta jone eshte oferta ekonomikisht me e leverdisshme.

Së dyti:

Nga KVO, eshte perdorur standart i dyfishte, pasi neve na ka skualifikuar per "mos paraqitje e dokumentit te lejes se bashkise per depozitimit te mbetjeve te rrezikshme spitalore pas perpunimit", ndersa te gjithë OE te tjere i ka kualifikuar, pavaresisht nga fakti se asnje prej tyre nuk ka paraqitur nje leje te tille, por te gjithë produktin qe del nga perpunimi e depozitohen neper landfill ose ne incinerator te posacem, pra te gjithë OE te tjere nuk kane paraqitur dokumentin qe pretendon KVO, por kontrate me landfill ose me incinerator. Kjo edhe sepse, ne baze te legjislacionit ne fuqi, nuk jane me bashkete qe leshojne leje te tilla, por trajtimi perfundimtar behet ne landfill ose ne incinerator. Pra, ne praktike nuk ekziston nje dokument i tille sic eshte cilesuar nga KVO "leje nga bashkia".

Per arsyet e mesiperme, kerkojme:

1. Te kualifikohet oferta jone dhe te konsiderohet e vlefshme; ose ne rast se dicka e tille nuk pranohet,
2. Të trajtohen ne menyre te barabarte te gjithë OE, dhe per te njejtin shkak te skualifikohen dhe te tre OE te tjere.

II.4.2. Referuar informacionit të dorëzuar nga autoriteti kontraktor si dhe dokumentacionit bashkëngjitur ankesës së operatorit ekonomik ankimues, autoriteti kontraktor në datën 29.03.2019, me anë të shkresës nr.482 prot., i ka kthyer përgjigje ankesës së operatorit ekonomik ankimues duke e refuzuar atë. Konkretisht, autoriteti kontraktor, në kthimin e përgjigjes ka argumentuar:

"[...] Nga ana e firmes suaj keni bere ankese per skualifikim ne objektin 'Eliminim Mbetjesh Spitalore te rrezikshme" konkretisht per pike Operator Ekonomik duhet te kete leje nga bashkia per depozitimin e produkteve qe dalin nga perpunimi. Kjo pike nuk eshte vleresuar nga ana juaj, pasi firmat e tjera pjesemarrrese e kane vleresuar dhe e kane sjelle Kontraten me Landfillin, pasi

ky kriter kualifikues qe kemi vendosur pasqyrohet me anen e kesaj kontrate, qe tre operatoret e tjere e kane sjelle. Pasi u shqyrtuan me kujdes te gjitha dokument qe kane paraqitur firmat pjesemarrrese prane KVO-se, operator ekonomik "V.A.L.E. Recycling" sh.p.k. nuk ka plotesuar kriterin kualifikues te vendosur ne DST per depozitimin e mbetjeve te rrezikshme spitalore prane landfillit. Dokumenti qe i bashkangjitet ankeses suaj duhet te ishte paraqitur ne kohe bashkelidhur me gjithe materialet e tjera qe ju keni dorezuar.

II.4.3. Në datën 05.04.2019 operatori ekonomik "V.A.L.E. Recycling" sh.p.k. ka paraqitur ankesë në Komisionin e Prokurimit Publik duke të njëjtat pretendime për arsyet e skualifikimit të lëna në fuqi nga autoriteti kontraktor.

II.5. Nëpërmjet shkresës nr. 543/1 prot., datë 12.04.2019, protokolluar me tonën në datën 15.04.2019, me objekt "Përgjigje në zbatim të vendimit Nr.627/1 prot., datë 09.04.2019" është depozituar në Komisionin e Prokurimit Publik informacioni i autoritetit kontraktor lidhur me procedurën e mësipërme të prokurimit dhe trajtimin e ankesës së operatorit ekonomik ankimues.

### III

#### Komisioni i Prokurimit Publik

pas shqyrtimit të ankesës, dokumentacionit bashkëngjitur, si edhe informacionit dhe dokumentacionit të autoritetit kontraktor

#### Arsyeton

III.1. Lidhur me pretendimin e operatorit ekonomik ankimues "V.A.L.E. Recycling" sh.p.k. për kundërshtimin e arsyes së skualifikimit të ofertës së tij ekonomike, me argumentin se "...Sic vihet re, nga specifikimet e mesiperme, vete AK, kerkesat e pikes 2.3 me siper, i ka konceptuar si specifikime teknike te pergjithshme, disa prej te cilave verifikohen ne fazen e konkurimit, ndersa disa te tjera jane specifikime qe lidhen me fazen e zbatimit te kontrates.

Per disa prej ketyre specifikimeve, AK ka kerkuar dhe ka identifikuar dokumenta konkrete specifike qe OE duhet te paraqesin, ndersa per disa te tjera, vetem i ka pershkruar si specifikime qe duhet te verifikohen gjate hartimit te kontrates dhe nuk ka indikua nje dokument konkret qe OE duhet te paraqesin per qellime kualifikimi. Ne kete kontekst, nga ana jone, pervec Shtojces 6 "DEKLARATE MBI PERMBUSHEN E SPECIFIKIMEVE TEKNIKE", kemi paraqitur edhe nje VETEDEKLARATE me permbajtjen si vijon: "-Plotesojme të gjitha kapacitetet teknike të kerkuara në pikën 2.3 "Kapaciteti Teknik", të Shtojces 9 te Dokumentave të Tenderit, në mbështetje të Ligjit Nr. 10463 datë 22.09.2011 "Për Menaxhimin e Integruar të Mbetjeve", i ndryshuar, VKM Nr. 798 datë 29.09.2010 "Për Administrimin e Mbetjeve Spitalore, Ligjit Nr. Nr. 10431, datë 9.6.2011 "Per mbrojtjen e mjedisit", VKM Nr. 99 datë 18.02.2005 "Per Miratimin e Katalogut Shqiptar te Klasifikimit te Mbetjeve".

-Aty ku eshte kerkuar, kemi paraqitur edhe dokumentacionin perkates."

*Pra, eshte e qarte, se ne pergjigje te menyres se si AK i ka ndertuar keto kerkesa ne formen e specifikimeve, ne me pergjegjesi te plote kemi deklaruar permbushjen e tyre dhe aty ku jane kerkuar dokumenta konkrete, te percaktuar qartesisht, i kemi paraqitur keto dokumenta. Sigurisht, qe nga ana jone, eshte lehtesisht e provueshme se e kemi te realizuar edhe zgjidhjen per depozitim dhe produktit te pademshem qe del nga perdorimi (pika 16 e listes se sipercituar te kerkesave specifikimeve teknik). Po ju bashkelidhim per qellime provuese Kontraten perkatese me Landfillin e Bushatit. Sidoqofte, vete AK, ka percaktuar ne fund te listes se sipercituar ne pike 2.3 qe "KVO rezervon te drejten e verifikimit te te dhenave te paraqitura nga ofertuesit "Pra, ne zbatim te ketij percaktimi dhe te nenit 53/1 te LPP, KVO e AK, mund te kishte kerkuar sqarime dhe te bente verifikime per deklarimet tona, nisur edhe nga fakti, qe oferta jone eshte oferta ekonomikisht me e leverdisshme.", Komisioni i Prokurimit Publik vëren se:*

III.1.1. Në dokumentat e tenderit, Shtojca 9 “Kriteret e Veçanta të Kualifikimit”, pika 2.3 “Për kapacitetin teknik”, pika 16, nga autoriteti kontraktor është përcaktuar kriteri:

*“11. Operatori Ekonomik duhet të ketë leje nga bashkia për depozitim dhe produkteve që dalin nga përpunimi.”*

Gjithashtu, në paragrafin e fundit të po kësaj shtojce autoriteti kontraktor ka përcaktuar:

*“Të gjithë dokumentat duhet të jenë origjinalë ose kopje të noterizuara të tyre. Rastet e mosdorëzimit të një dokumenti, ose të dokumentave të rreme e të pasakta, konsiderohen si kushte për skualifikim.”*

III.1.2. Nga shqyrtimi i dokumentacionit të dorëzuar në Sistemin e Prokurimit Elektronik nga operatori ekonomik “V.A.L.E. Recycling” sh.p.k., rezulton se ky i fundit ka paraqitur dokumentacion si më poshtë vijon:

- “Deklaratë mbi Përmbushjen e Specifikimeve Teknike” e firmosur nga operatori ekonomik “V.A.L.E. Recycling” sh.p.k.
- “Deklaratë mbi Kapacitetet Teknike” e firmosur nga operatori ekonomik “V.A.L.E. Recycling” sh.p.k.

III.1.3. Në nenin 46, pika 1/a e ligjit nr.9643 dt.20.11.2006 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar parashikohet se: “[...] Operatorët ekonomikë, për të marrë pjesë në procedurat e prokurimit, duhet të kualifikohen, pasi të kenë përmbushur të gjitha kriteret e mëposhtme, që autoriteti kontraktor i vlerëson të nevojshme, për sa kohë që ato janë në përpjesëtim me natyrën dhe përmasat e kontratës që do të prokurohet dhe jodiskriminuese.

Ndërsa në nenin 53, pika 3 të ligjit nr.9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, përcakohet se: “Autoriteti kontraktor, në zbatim të pikës 4 të këtij neni, vlerëson një oferte të vlefshme, vetëm nëse ajo është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dokumentat e tenderit... .”

III.1.4. Në nenin 28, pika 2 të Vendimit nr.914 datë 29.12.2014 të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, të ndryshuar parashikohet se “Kërkesat e veçanta të kualifikimit duhet të përfshijnë të gjitha kriteret specifike në përputhje me nenin 46 të LPP. Kriteret duhet të jenë në përpjesëtim dhe të lidhura ngushtë me aftësinë zbatuese, natyrën dhe vlerën e kontratës. Në çdo rast, autoriteti kontraktor duhet të përcaktojë dokumentet konkrete që duhet të paraqesin operatorët ekonomikë për përmbushjen e këtyre kriterëve”.



III.1.5. Kriteret për kualifikim vendosen që t'i shërbejnë autoritetit kontraktor për të krijuar një panoramë të përgjithshme të kapaciteteve dhe mundësisë së operatorit për përmbushje me sukses të kontratës. Në varësi të kontratës dhe volumit të saj autoriteti kontraktor përcakton kërkesat e veçanta për kualifikim, të cilat janë të detyrueshme për t'u përmbushur nga operatorët ekonomikë pjesëmarrës në procedurat e prokurimit. Operatorët ekonomikë janë të detyruar të përgatisin ofertat, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në dokumentat e tenderit dhe ofertat që nuk përgatiten në përputhje me këto dokumenta duhet të refuzohen si të papranueshme.

III.1.6. Nga shqyrtimi i dokumentave të tenderit, KPP vëren se, autoriteti kontraktor në shtojcën 9, "Kriteret e Veçanta të Kualifikimit", "Për Kapacitetin Teknik", pika 16, ka kërkuar shprehimisht që operatorët ekonomik duhet të jenë të pajisur me leje nga bashkia për depozitimin e produkteve që ndalin nga përpunimi.

Nisur nga arsyeja e skualifikimit të dhënë nga autoriteti kontraktor për operatorin ekonomik ankimues, si dhe kërkesa e përcaktuar në dokumentat e tenderit, KPP nga verifikimi i dokumentacionit të dorëzuar nga operatori ekonomik "V.A.L.E. Recycling" sh.p.k. në SPE, konstaton se, ky i fundit nuk ka paraqitur asnjë dokument me anë të të cilit të vërtetojë se plotëson kërkesën e vendosur nga autoriteti kontraktor në kriterin e mësipërm.

Akoma më tej, vetë operatori ekonomik ankimues si në ankesën e paraqitur pranë autoritetit kontraktor dhe në ankesën e paraqitur pranë Komisionit të Prokurimit Publik, pranon në mënyrë të shprehur se nuk ka sjellë asnjë dokumentacion për të përmbushur kriterin e mësipërm, por citon se "...përvec Shtojcës 6 "Deklarate mbi Permbushjen e Specifikimeve Teknike", kemi paraqitur edhe një Vetedeklaratë me përmbajtjen si vijon: "-Plotesojme të gjitha kapacitetet teknike të kerkuara në pikën 2.3 "Kapaciteti Teknik", të Shtojcës 9 të Dokumentave të Tenderit, në mbështetje të Ligjit Nr. 10463 datë 22.09.2011 "Për Menaxhimin e Integruar të Mbetjeve", i ndryshuar, VKM Nr. 798 datë 29.09.2010 "Për Administrimin e Mbetjeve Spitalore, Ligjit Nr. Nr. 10431, datë 9.6.2011 "Per mbrojtjen e mjedisit", VKM Nr. 99 datë 18.02.2005 "Per Miratimin e Katalogut Shqiptar të Klasifikimit të Mbetjeve". Aty ku është kerkuar, kemi paraqitur edhe dokumentacionin perkates." Pra, është e qarte, se ne pergjigje te menyres se si AK i ka ndertuar keto kerkesa ne formen e specifikimeve, ne me pergjegjesi te plote kemi deklaruar permbushjen e tyre dhe aty ku jane kerkuar dokumenta konkrete, te percaktuar qartesisht, i kemi paraqitur keto dokumenta". Pra, operatori ekonomik ankimues pretendon se, për të përmbushur kriterin e mësipërm, të vendosur nga autoriteti kontraktor, ka paraqitur një "Vetëdeklaratë", ku shprehet se plotëson të gjitha kërkesat e vendosura nga autoriteti kontraktor në Specifikimet teknike. Në lidhje me pretendimin e operatorit ekonomik ankimues së ka plotësuar deklaratën për përmbushjen e kapacitetit teknik, sqarojmë se në Shtojcën 9, "Kriteret e Veçanta të Kualifikimit", "Kapaciteti teknik", është përcaktuar kriteri "Operatori Ekonomik duhet të ketë leje nga bashkia për depozitimin e produkteve që dalin nga përpunimi", i cili është i detyrueshëm (ashtu si të gjithë kriteret e tjera të përcaktuara në këtë shtojcë) për tu përmbushur nga të gjithë operatorët ekonomikë pjesëmarrës. Paraqitja e deklaratës nga operatori ekonomik ankimues, për kapacitetin teknik dhe specifikimet teknike, nuk përfshin përmbushjen e kriterëve të përcaktuara në Shtojcën 9 të dokumentave të tenderit.

III.1.7. Sa më sipër, nga dokumentacioni i paraqitur nga operatori ekonomik ankimues, në asnjë moment nuk vërtetohet dhe nuk dokumentohet fakti se shoqëria "V.A.L.E. Recycling" sh.p.k. është i pajisur me leje nga bashkia për depozitimin e produkteve që dalin nga përpunimi. Në rastin

konkret, dokumentacioni i paraqitur nga ana e ankimuesit në këtë procedurë prokurimi, objekt shqyrtimi, nuk është i rregullt, pasi ka mungesë fizike të dokumentacionit, kërkesa këto të përcaktuara nga autoriteti kontraktor në dokumentat e tenderit.

III.1.8. Kriteret për kualifikim i shërbejnë autoritetit kontraktor për njohjen e gjendjes dhe kapaciteteve të operatorëve ekonomikë, të cilët, nëpërmjet dokumentacionit të paraqitur duhet të vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet organizative, makineritë, pajisjet e asete të tjera fizike, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, gjithçka në funksion realizimit me sukses të kontratës. Mosplotësimi qoftë edhe i një kriteri të vendosur nga ana e autoritetit kontraktor e bën ofertën e operatorit ekonomik të pavlefshme, si edhe përbën kusht për skualifikimin e tij nga procedura e prokurimit. Operatori ekonomik nuk ka paraqitur dokument për të provuar se është i pajisur me lejen e kërkuar nga autoriteti kontraktor.

Sqarojmë se, bazuar edhe në nenin 82 pika 1 të ligjit 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative i RSH”, barra e provës për të vërtetuar plotësimin e kriterit të përcaktuar nga autoriteti kontraktor, bie mbi operatorin ekonomik, i cili në rastin konkret ka dështuar ta vërtetojë atë.

Nuk mund të lejohet kualifikimi i një operatori ekonomik në rast se ai ka mungesë dokumentacioni dhe nuk plotëson kriteret e përcaktuara nga vetë autoriteti kontraktor.

Në rastin konkret, dokumentacioni i paraqitur nga ana e ankimuesit në këtë procedurë prokurimi, objekt shqyrtimi, nuk është i rregullt dhe për shkak të mangësive që ka nuk plotëson kërkesat e autoritetit kontraktor dhe si i tillë konsiderohet i pavlefshëm.

III.1.9. Komisioni i Prokurimit Publik, sqaron se, në rast se, operatori ekonomik ankimues do të kishte pretendime në lidhje me kërkesën e mësipërme të autoritetit kontraktor, ka patur në dispozicion momentin procedural të paraqitjes së ankesës mbi hartimin e dokumenteve dhe kriterëve të veçanta të kualifikimit të procedurës së prokurimit objekt ankimi, parashikuar nga neni 63 pika 1/1 e LPP. Në nenin 63 pika 1/1 të ligjit nr.9643 datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar parashikohet se *“Në rastin e ankesave për dokumentet e tenderit, operatorët ekonomikë mund të ankohen pranë autoritetit kontraktor brenda 7 ditëve nga data e publikimit të njoftimit të kontratës në faqen në internet të Agjencisë së Prokurimit Publik. Me marrjen e ankesës me shkrim, autoriteti kontraktor pezullon vazhdimin e procedurës së prokurimit, derisa ankesa të jetë shqyrtuar plotësisht, përfshirë dhe nxjerrjen e një vendimi brenda 3 ditëve nga data e depozitimit të ankesës. Ndaj vendimit përfundimtar të autoritetit kontraktor mund të bëhet ankim në Komisionin e Prokurimit Publik, në përputhje me pikën 6 e në vijim të këtij neni”*.

Gjithashtu, kuadri ligjor parashikon një sërë elementësh si garanci për operatorët ekonomikë të cilët kanë paqartësi në lidhje me interpretimin e kërkesave të autoritetit kontraktor dhe/ose mënyrës së plotësimit të kriterëve kualifikuese. Në rast se operatori ekonomik ankimues do të kishte paqartësi në lidhje mbi plotësimin e kërkesës së mësipërme, ka në dispozicion momentin procedural të paraqitjes së kërkesës për sqarime pranë autoritetit kontraktor deri në pesë ditë para dorëzimit të ofertave parashikuar nga neni 42 i LPP-së. Në nenin 42, pika 1 të ligjit nr.9643 datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar, parashikohet se *“[...] Ofertuesi i mundshëm mund të kërkojë sqarime për dokumentet e tenderit nga autoriteti kontraktor, i cili duhet t'i përgjigjet çdo kërkesë për sqarim të dokumenteve të tenderit, të bërë nga çdo operator ekonomik, me kusht që kërkesa të jetë marrë jo më vonë se 5 ditë para afatit përfundimtar të dorëzimit të ofertave. Autoriteti kontraktor duhet të përgjigjet brenda 3 ditëve nga depozitimi i kërkesës, në*

*mënyrë që të bëjë të mundur dorëzimin e ofertës në kohë nga operatori ekonomik dhe, pa identifikuar burimin e kërkesës, duhet t'ia komunikojë sqarimin përkatës të gjithë operatorëve ekonomikë, që kanë tërhequr dokumentet e tenderit [...]”.*

Rrjedhimisht, sa më sipër, pretendimi i operatorit ekonomik ankimues, nuk qëndron.

III.2. Në lidhje me pretendimet e operatorit ekonomik ankimues “V.A.L.E. Recycling” sh.p.k. mbi ofertat e operatorëve ekonomikë të kualifikuar në procedurën e mësipërme të prokurimit, Komisioni i Prokurimit Publik para shqyrtimit në themel të pretendimeve të operatorit ekonomik ankimues, konstaton se ky i fundit nuk legjitimohet për të paraqitur ankesë pranë Komisionit të Prokurimit Publik, për shkak se nuk gëzon asnjë interes të ligjshëm në këtë procedurë prokurimi.

III.2.1. Neni 63, pika 1, i Ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, me titull “Të drejtat e personit të interesuar” parashikon se: “Çdo person, që ka ose ka pasur interes në një procedurë prokurimi dhe kur është dëmtuar ose rrezikohet të dëmtohet nga një vendim i autoritetit kontraktor, i marrë në kundërshtim me këtë ligj, mund ta kundërshtojë vendimin”.

III.2.2. Komisioni i Prokurimit Publik sqaron se një person fizik apo juridik, kur dorëzon një ankim, duhet të paraqesë (argumentojë) se të drejtat e tij të mbrojtura nga legjislacioni janë dëmtuar si rezultat i një vendimi, mase apo të ndonjë veprimi tjetër zyrtar nga ana e një autoriteti kontraktor. Nëse ai dështon në sa më sipër, atëherë ankimi në KPP është i papranueshëm.

Neni 63, pika 1, kërkon shprehimisht që ankimuesi, jo vetëm të ketë interes, por edhe të jetë dëmtuar realisht apo të rrezikohet të dëmtohet nga vendimi që ka marrë autoriteti kontraktor.

III.2.3. I vetmi interes i ligjshëm, që mund të ketë një operator ekonomik i dëmtuar nga një vendim i një autoriteti kontraktor, i dhënë në kuadrin e një procedure prokurimi është që, përmes ankimit në KPP, ai të fitojë kontratën. Në ato raste kur, operatori ekonomik ankimues edhe pas ankimit në KPP rezulton i s’kualifikuar nga procedura e prokurimit, atëherë ai qartësisht nuk mund ta fitojë kontratën. Edhe në hipotezën se, pretendimet e parashtruara në ankimin e tij në lidhje me operatorët e tjerë pjesëmarrës në procedurën e prokurimit, do të pranohen nga KPP, ankimuesi sërish nuk do të ishte fitues i kontratës.

Rrjedhimisht, në rast se operatori ekonomik që ka paraqitur ankimin vijon të mbetet i skualifikuar apo skualifikohet gjatë shqyrtimit në KPP, në kuptim të ligjit, interesi i tij i ligjshëm, i drejtpërdrejtë e real (*përkundrejt atij imagjinar*) nuk ka sesi të dëmtohet nga suksesi apo dështimi i operatorëve të tjerë në atë procedurë prokurimi.

Në rastin konkret, për sa kohë operatori ekonomik ankimues “V.A.L.E. Recycling” sh.p.k., vijon të mbetet i skualifikuar nga procedura e prokurimit objekt shqyrtimi, rrjedhimisht, ky i fundit nuk legjitimohet të paraqesë ankesë për operatorët e tjerë ekonomikë pjesëmarrës në procedurën e mësipërme të prokurimit.

Përsa më sipër, në mbështetje të nenit 19/1 dhe vijues, të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar, nenit 31 të Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 596/2018, datë 12.09.2018 “Për miratimin e rregullave “Për organizimin dhe funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, Komisioni i Prokurimit Publik, njëzëri,

## Vendos

1. Të mos pranojë ankesën e paraqitur nga operatori ekonomik “V.A.L.E. Recycling” sh.p.k. për procedurën e prokurimit “*Procedurë e hapur*”, me nr. REF-02543-12-28-2018, me objekt “*Shërbim Eleminim mbetjesh të rrezikshme - Marrëveshje Kuadër me 1 operatorë ekonomik - ku të gjitha kushtet janë të përcaktuara - me afat 1 vjeçar (12 muaj)*”, me fond limit 8.910.000 lekë (pa TVSH), zhvilluar në datën 08.03.2019, nga autoriteti kontraktor, Spitali Universitar Obstetrik Gjinekologjik “Koço Gliozheni.
2. Autoriteti kontraktor lejohet të vijojë me hapat e mëtejshëm të procedurës së prokurimit.
3. Kundër këtij vendimi, mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë, Tiranë.
4. Kopje e këtij vendimi i dërgohet për njoftim Agjencisë së Prokurimit Publik.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

**Nr. 627 Protokolli**

**Datë 05.04.2019**

### **KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK**

<b>Nënkryetar</b>	<b>Anëtar</b>	<b>Anëtar</b>	<b>Anëtar</b>
<b>Enkeleda Bega</b>	<b>Vilma Zhupaj</b>	<b>Lindita Skeja</b>	<b>Merita Zeqaj</b>

**Kryetar**  
**Evis Shurdha**